



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K14/I 73-9 Prot.
Nr. Dok. 202503147/9

Tiranë 18.12.2025

Lënda: *Rekomandim për ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Himarë, për hartimin e programeve të strehimit për shtresat në nevojë në përputhje me legjislacionin në fuqi;*

Drejtuar: BASHKISË HIMARË

Për dijeni: KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Të nderuar,

Avokati i Popullit si institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, shërben si garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt, ose jo në Shqipëri, refugjatë, si dhe të personave pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Në përmbushje të misionit kushtetues, si garant i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nxitës i standardeve më të larta të këtyre të drejtave, institucioni i Avokatit të Popullit i kushton një vëmendje të posaçme dhe ndjek e trajton me prioritet mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të grupeve në nevojë.

Siç jeni në dijeni nga komunikimet e mëparshme institucionale, institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13, të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, nisur nga lajmi i publikuar në median online me titull: “*L. kërkon ndihmë, prej dy muajsh fle në shezlonget e Borshit*”¹, ka filluar me nismën e tij, ndjekjen e kësaj çështjeje.

Në lajmin e publikuar morëm informacion mbi një grua 51-vjeçare, të quajtur L., e cila prej dy muajsh është e detyruar të flejë jashtë, në shezlongë, pasi është përzënë nga familja e saj. E vetme, pa mbështetje dhe pa asnjë të ardhur, ajo ka mbetur pa strehë, ndërkohë që nëna, dy vëllezërit dhe motra nuk e kanë pranuar për shkak të varfërisë së skajshme. Gjendja e saj shëndetësore është rënduar më tej, pasi është infektuar dhe nuk ka mundësi të blejë as ilaçet bazë. Për ushqim varet vetëm nga ndihma e rastësishme e qytetarëve.

Pas publikimit të lajmit, u kontaktua personalisht qytetarja në numrin e saj, të vendosur në dispozicion nga media, për të mesuar më shumë rreth fakteve dhe për të marrë të dhënat personale. Qytetarja L.I., e lindur në Borsh, ka konfirmuar se gjendja e saj është shumë e vështirë. Ajo ndodhej në Qeparo, pranë një plazhi të përdorur nga kamperë, ku po përpiqet të qëndrojë pa asnjë mbrojtje të sigurt.

Në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, Avokati i Popullit, pasi është njohur me problematikën e sipërcituar, vendosi marrjen në shqyrtim të saj dhe nisjen e hetimit administrativ, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar².

Në kuadër të hetimit administrativ, të orientuar për gjetjen e një zgjidhjeje të drejtë e të qëndrueshme të rastit, Avokati i Popullit, në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor³, i ka kërkuar Bashkisë Himarë, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Vlorë dhe Bashkisë Sarandë, informacion dhe shpjegime, lidhur me situatën social ekonomike të qytetares dhe mundësitë për ta ndihmuar atë në adresimin e problematikës së evidentuar.

Në përgjigje të kërkesës sonë për informacion dhe shpjegime⁴, Bashkia Himarë informon sa vijon:

¹ Lajmi i publikuar në median online “JOQ”, në platformën Instagram, më datë 11.07.2025;

<https://www.instagram.com/p/DL9kHXFMkJ/?igsh=NDYyMnNyOTZhMG9y>

² Neni 13, paragrafi i parë: “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”.

³ Neni 63, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet: “Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”, si dhe neni 19 pika b, Ligji Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”.

⁴ Shkresa nr. K1/I73-2 prot., datë 29.07.2025 “Kërkesë për shpjegime” Bashkisë Himarë.;

Në përgjigje të shkresës suaj nr. K1/1 73-2, datë 29.07.2025, protokolluar në institucionin tonë me nr. 5971 prot., datë 31.07.2025, lidhur me kërkesën për marrjen e masave në lidhje me rastin e znj. L., të publikuar në rrjetet sociale nga media online "JOQ", ju informojmë si më poshtë:

Rasti i znj. L.I. është referuar për herë të parë pranë institucionit tonë më datë 27.01.2025, nëpërmjet një kallëzimi të paraqitur në Komisaratin e Policisë Himarë nga nëna e saj, znj. B. I.. Kjo e fundit ka kërkuar lëshimin e një urdhri mbrojtjeje, duke deklaruar se ndihej e kërcënuar nga vajza e saj, e cila ushtronte dhunë ndaj saj dhe dy fëmijëve të saj me probleme të shëndetit mendor. Znj. B. ka bërë me dije se pas divorcit, vajza e saj L. mbeti pa strehë dhe u rikthye në banesën e prindërve në fshatin Borsh, gjë që nuk u prit mirë nga familjarët. Si pasojë, me vendimin nr. Regj. Themeltar 16(21017- 00145-61-2025), datë 29.01.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë vendosi lëshimin e një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje në favor të znj. B. I. Më datë 29.04.2025, znj. L.I. ka paraqitur një kërkesë pranë Bashkisë Himarë për përfitim nga programet e strehimit. Në përgjigje të saj, është informuar se aktualisht Bashkia nuk disponon banesa sociale dhe nuk ka në funksion programe për bonus qiraje. E vetmja mundësi që ofrohet është programi për restaurimin e pjesshëm të banesave shumë të amortizuara.

Gjithashtu, sqarojmë se Bashkia Himarë nuk ka në dispozicion streheza emergjente apo bashkëpunime me organizata jofitimprurëse që ofrojnë strehim për individë në situatë rruge apo nevojë. Në këto kushte, është e pamundur të ofrohet mbështetje e menjëhershme për rastin konkret. Megjithatë, znj. L. është kontaktuar nga administratorja sociale e njësisë përkatëse dhe është informuar për mundësinë e përfitimit të ndihmës ekonomike. Për këtë qëllim, i është shpjeguar se fillimisht duhet të realizojë procedurën e ndarjes nga trangu familjar, për të mundësuar aplikimin e mëvonshëm në skemën e ndihmës ekonomike.

Në përgjigje të kërkesës për informacion dhe shpjegime⁵, DRSHTSH Vlorë informon sa vijon:

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. K1/173-3 Prot. datë 29.07.2025, protokolluar me tonën me Nr. 1519 Prot. datë 31.07. 2025 lidhur me kërkesën për shpjegime për znj. L. I. mbi lajmin e publikuar në median online, ju bëjmë me dije se: Drejtoria Rajonale Vlorë e ka referuar rastin e znj. L. I. në Bashkinë Himarë.

Pas verifikimeve të kryera nga Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë në Bashkinë Himarë, na kanë venë djeni për situatën social-ekonomike të qytetares si më poshtë vijon: "Në lidhje me lajmin e publikuar së fundmi në rrjetet sociale, konkretisht në faqen "JOQ Albania", ku është bërë publik rasti i një zonje

⁵ Shkresa nr. K1/I73-3 prot., datë 29.07.2025 "Kërkesë për shpjegime" DRSHTSH Vlorë.;

e gjendur në kushtet e pastrehësisë në fshatin Borsh, Njësia Administrative Lukovë, Bashkia Himarë, ju informojmë si më poshtë: Rasti i znj. L.I. është referuar për herë të parë pranë institucionit tonë më datë 27.01.2025, përmes një kallëzimi të depozituar në Komisaratin e Policisë Himarë nga nëna e saj, znj. B. I. Kjo e fundit paraqiti një kërkesë për urdhër mbrojtjeje, duke deklaruar se ndihej e kërcënuar nga vajza e saj, e cila ushtronte dhunë ndaj saj dhe ndaj dy fëmijëve të saj që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor. Znj. B. bëri me dije se pas divorcit nga bashkëshorti, vajza e saj L. mbeti pa strehë dhe u rikthye në familjen e origjinës në fshatin Borsh, çka nuk u mirëprit nga familjarët. Si rezultat, më datë 29.01.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin Nr. Regj. Themeltar 16(21017-00145-61-2025), vendosi lëshimin e një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje në favor të znj. Baftjare Idrizaj. Më datë 29.04.2025, znj. L.I. ka paraqitur pranë Bashkisë Himarë një kërkesë për strehim, duke kërkuar përfitim nga programet përkatëse të institucionit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Himarë e ka informuar se aktualisht nuk disponon banesa sociale apo programe për bonus qiraje. Institucioni ofron vetëm programin për restaurimin e pjesshëm të banesave shumë të amortizuara. Gjithashtu, sqarojmë se Bashkia Himarë nuk disponon streheza emergjente apo organizata jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për individë në situatë rruge apo në nevojë. Në këto kushte, është e vështirë të ofrohet asistencë e drejtpërdrejtë për rastin në fjalë, për më tepër që nga vendimi gjykatës znj. L. I. rezulton me vendbanim në Bashkinë Sarandë."

Pas informacionit të Bashkisë Himarë, bashkëpunuam me Administratoren Shoqërore të Zyrës së Ndihmës Ekonomike të Njesisë Administrative Lukovë, Bashkia Himarë. Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreu V, neni 23, Administratorja Shoqërore ka për detyrë: a) të identifikojnë familjet dhe individët në nevojë dhe t'i ftojnë e t'i informojnë për aplikim për ndihmë ekonomike; b) të plotësojnë aplikimin për familjet dhe individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar; Administratorja Shoqërore pas komunikimit në telefon me qytetaren konstatoi se znj. L.I. jeton në një dhomë në Qeparo të cilën ja ka venë në dispozicion e afërmja e saj.

Gjithashtu pas identifikimit të rastit si familje në nevojë, u informua znj. L. I. se nga data 01-10 Gusht 2025 mund të paraqitet pranë Njesisë Administrative Lukovë, për të aplikuar për Ndihmë Ekonomike si familje në nevojë.

Në vijim për të marrë të dhëna të mëtejshme lidhur me informacionin e përcjellë nga DRSHSSH Vlorë ku cilësohet se qytetarja është banore e Bashkisë Sarandë,

institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi shpjegime⁶ nga Bashkia Sarandë, e cila përcolli informacionin, si vijon:

Lidhur me rastin e Znj. L. I. referuar nga JU, ju bëjmë me dije se rasti na është referuar më herët edhe nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale, Vlorë. Ne verifikuam pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Bashkinë Sarandë nëse në këtë bashki rezulton të ketë vendbanimin ndonjë person me emrin L. I. dhe përgjigja ishte se nuk ka person me këtë emër në Bashkinë Sarandë, por rezulton një i tillë në Borsh, Bashkia Himarë.

Në Bashkinë Sarandë nuk ka streha për të pastrehët kurse shërbimet e tjera si Ndihma ekonomike dhe ndihmë nga programet e strehimit ofrohen vetëm për banuesit e Bashkisë Sarandë, pasi edhe sistemet e aplikimit nuk pranojnë aplikime nga qytetare të bashkive të tjera.

Konsiderata të Avokatit të Popullit.

Për të përmirësuar kushtet e jetesës së qytetarëve, anëtarë të grupeve në nevojë, lidhur me kushtet e tyre të vështira të jetesës, strehimit dhe për të siguruar që ata të jetojnë në përputhje me standardet e pjesës tjetër të popullsisë në vendin tonë, është e nevojshme të përmbushen detyrimet që rrjedhin nga angazhimet ndërkombëtare dhe nga kuadri i brendshëm ligjor. Mungesa e kushteve minimale të jetesës së këtyre qytetarëve është një problem serioz që krijon premisat që anëtarë të këtyre grupeve të ndihen të diskriminuar, të pabarbartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen. Për të mundësuar përmirësimin e kushteve të jetesës për këto grupe të marginalizuara nevojitet kuptim, dedikim dhe koordinim ndërinstitutional, i cili ka një rëndësi thelbësore për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të këtyre qytetarëve.

E drejta për strehim është një prej të drejtave themelore të rëndësishme të njeriut, që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për jetën dhe shëndetin dhe si e tillë përfshihet në një numër të konsiderueshëm të instrumentave të së drejtës ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në nenin 25.1, përcakton se: “Çdokush ka të drejtën e një standardi jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin.” Ky formulim thekson se strehimi

⁶ Email datë 26.08.2025 “Kërkesë për shpjegime” Bashkisë Sarandë.

është një element i domosdoshëm për të garantuar dinjitetin dhe mirëqenien e individit dhe familjes. Në të njëjtën linjë, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila përbën pjesë të rendit juridik të brendshëm të Shqipërisë nëpërmjet jurisprudencës së pasur të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e njeh të drejtën për strehim si një të drejtë themelore, duke e lidhur ngushtësisht me të drejtën për jetën private dhe familjare, sigurinë dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor. Po kështu, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore u ngarkon shteteve palë detyrimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim realizimin progresiv të së drejtës për strehim të përshtatshëm, duke garantuar jo vetëm një hapësirë fizike për banim, por edhe kushte të sigurta, të përballueshme dhe të qëndrueshme jetese. Gjithashtu, Karta Sociale Evropiane dhe Karta Sociale Evropiane e Rishikuar, theksojnë të drejtën për mbrojtje sociale dhe të drejtën e drejtpërdrejtë për strehim. Neni 16 i Kartës “E drejta e mbrojtjes sociale, ligjore dhe ekonomike e familjes”, cilëson; *Me qëllim që të sigurojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin e plotë të familjes, e cila është bërthama themelore e shoqërisë, Palët Kontraktuese marrin përsipër të nxisin mbrojtjen e jetës familjare ekonomike dhe sociale me anë të mjeteve të tilla si përfitimet sociale dhe familjare, marrëveshjet fiskale, ofrimin e strehimit familjar, përfitime për të sapo martuarit dhe mjete të tjera të përshtashtme.* Neni 31 i Kartës Sociale Evropiane parashikon: *“Të drejtën e strehimit”*. Me qëllim që të garantojë zbatim efektiv të së drejtës për strehim, palët marrin përsipër masa të cilat:

- nxisin aksesin tek strehimi i një standardi të përshtatshëm;
- nxisin dhe zvogëlojnë mosstrehimin me qëllim eliminimin e plotë të tij;
- ofrimin e çmimeve të shtëpive që janë të përballueshme për ata që nuk kanë mjetet e përshtatshme.”

Sipas këtyre instrumentave ndërkombëtarë, shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore për strehim dhe të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Sa më sipër, duhen pasur në konsideratë edhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) për zbatimin e të cilave institucioni i Avokatit të Popullit kontribuon duke orientuar institucionet t’i qëndrojnë pranë qytetarëve më në nevojë, për të mos i rrezikuar ofrimin e shërbimeve adekuate dhe të qëndrueshme për ta. Një nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm është siguri i të gjithë qytetarëve, me prioritet shtresat në nevojë, për të patur të drejta të barabarta dhe qasje në shërbimet themelore. Deri në vitin 2030 duhet siguruar qasja në strehim të përshtatshëm, të përballueshëm dhe të arritshëm për të gjithë. Zbatimi i

Agjendës 2030 “Për Zhvillimin e Qëndrueshëm”⁷ është thelbësor, për sigurimin e mirëqënies dhe gëzimit të të gjithë të drejtave për qytetarët. Angazhimi kryesor që “Asnjë të mos mbetet pas” përbën parimin kyç të të gjitha Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

E drejta për strehim në Republikën e Shqipërisë është e garantuar nga Kushtetuta. Në nenin 59, pika 1, gërma “b”, kjo e drejtë përfshihet në objektivat sociale të shtetit, ku sanksionohet qartë se: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim.” Kjo dispozitë reflekton angazhimin e shtetit për të siguruar kushte minimale jetese për të gjithë qytetarët, përmes një mbështetjeje institucionale të drejtë dhe të barabartë. Në këtë kontekst, edhe neni 38 i Kushtetutës thekson të drejtën e çdo individit për të zgjedhur vendbanimin e tij dhe për të lëvizur lirisht në çdo pjesë të territorit të Republikës. Megjithatë, ushtrimi i kësaj të drejtë lidhet ngushtë me faktin që individit duhet të ketë një strehë, që është elementi bazë i sigurisë dhe qëndrueshmërisë sociale. Gjithashtu, neni 15 i Kushtetutës përcakton qartë se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë “të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme”, duke vendosur kështu themelet e rendit juridik në vend. Kjo nënkupton se çdo individ, pa dallim, gëzon të njëjtat të drejta dhe është i mbrojtur nga çdo formë diskriminimi, përfshirë edhe në drejtim të të drejtës për strehim.

Vlen të theksohet se ligjvënësi ka parashikuar një sërë mekanizmesh ligjorë dhe instrumentesh procedurale në funksion të njësive të vetëqeverisjes vendore, me qëllim që këto të fundit të jenë në gjendje të ofrojnë mbështetje konkrete dhe efektive për shtresat e popullsisë që ndodhen në kushte të vështira socio-ekonomike. Legjislacioni në fushën e shërbimeve sociale synon në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë garantimin e një mbështetjeje të qëndrueshme për qytetarët dhe familjet që përballen me vështirësi ekonomike apo sociale. Në veçanti, për individët dhe familjet që ndodhen në situata të cënueshme, përfshirja aktive dhe bashkërendimi ndër-institucional përbëjnë elementë kyç për realizimin efektiv të politikave të mbrojtjes sociale. Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të çdo rasti duhet të bëhet në mënyrë të personalizuar, gjithëpërfshirëse dhe me ndjeshmëri të lartë sociale, në përputhje me standardet ligjore dhe etike që rregullojnë këtë fushë. Kjo qasje jo vetëm që synon trajtimin me dinjitet të individëve në nevojë, por forcon gjithashtu rolin e institucioneve vendore si garantë të mbështetjes sociale në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe barazisë para ligjit.

⁷ Kombet e Bashkuara (2015). Të transformojmë botën tonë: Axhenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030. Marrë nga <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication>, e aksesueshme në dhjetor 2015.

Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social” i përditësuar⁸, dhe aktet nënligjore, përfaqësojnë një kapërcim të qënësishëm cilësor në mënyrën si perceptohet strehimi i përballeshëm, si adresohen grupet në nevojë, dhe si hartohen programet e veçanta të strehimit. Ky ligj parashikon parimet për strehim të përshtatshëm⁹, duke përcaktuar edhe kriteret që e klasifikojnë strehimin e përshtatshëm¹⁰, llojet e programeve të strehimit, ndërthurjen e tyre me shërbimet sociale, rolin e njësisë të vetqeverisjes vendore dhe qendrore dhe kriteret për përfitim nga këto programe nga qytetarët në nevojë.¹¹

Bashkitë, si njësi të vetqeverisjes vendore, vendosen në një rol proaktiv dhe qendror, në ofrimin e strehimit social, duke qenë përgjegjëse për identifikimin dhe hartëzimin e grupeve të qytetarëve në nevojë, si dhe për përcaktimin e formave dhe mekanizmave të financimit të programeve të strehimit¹². Ky rol merr një rëndësi të veçantë për garantimin e një jete të përshtatshme, të sigurt dhe dinjitoze për çdo individ dhe familje që ndodhet në kushte të vështira ekonomike e sociale.

Për adresimin efektiv të problematikave të konstatuara dhe për përmirësimin e qasjes së qytetarëve në këto programe, organet e pushtetit vendor, në cilësinë e institucioneve përgjegjëse më afër komunitetit, duhet të ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje me standardet më të larta të qeverisjes lokale, duke respektuar parimin e subsidiaritetit. Ky parim kërkon që vendimmarrja dhe ofrimi i shërbimeve të bëhet në nivelin më afër qytetarit, me qëllim që nevojat të adresohen sa më drejtëpërdrejt dhe efektivisht. Referuar dispozitave të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, e konkretisht neni 3 i të cilit përcakton: *“Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve*¹³, është në misionin e organeve të qeverisjes vendore e kryesisht të bashkive, që të sigurojnë qeverisje të efektshme, efikase dhe sa më pranë komuniteteve, në mënyrë që t’u krijojnë

⁸ ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023;

⁹ Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar, nenet 3-10

¹⁰ Po aty, neni 4 “Parimet e strehimit të përshtatshëm”;

¹¹ Po aty, nenet 11, 12, 13;

¹² Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, neni 18, neni 69, pika 2, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 31, datë 18.11.2018 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, i Ministrisë të Financave;

¹³ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 3 përcakton: “Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet: a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; d) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; e) realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative”.

atyre mundësitë në lidhje me ofrimin e mbështetjes sociale¹⁴ për një jetë të përshtatshme e dinjitoze. Bashkitë duhet të sigurojnë mekanizmat ligjorë e financiarë për nxjerrjen e tyre nga mjerimi¹⁵.

Sa më sipër, bashkitë duhet të garantojnë jo vetëm reagimin ndaj ankesave individuale të qytetarëve, por edhe adresimin në mënyrë gjithëpërfshirëse të situatës së përgjithshme të strehimit social në territorin e tyre. Kjo nënkupton ofrimin e garancive të nevojshme social-ekonomike për qytetarët dhe grupet vulnerabël, duke siguruar respektimin e të drejtave themelore të njeriut, me theks të veçantë mbi të drejtën për strehim.

Lidhur me rastin konkret në trajtim, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se jemi përballë një situatë të mosofrimit të shërbimit ndaj të gjithë qytetarëve në nevojë, në territorin e Bashkisë Himarë, të cilët duhet të mbështeten dhe të përfitojnë nga programet e strehimit social, sikurse parashikohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur dhe po ndjek në vazhdimësi këtë problematikë, e cila ngërthen në vetvete të drejtën themelore të njeriut, të njohur si “e drejta për jetën”, e garantuar në nenin 21, të Kushtetutës.

Problematika e mungesës së programeve të dedikuara të strehimit social në Bashkinë Himarë, i mohon qytetarëve në nevojë, aksesin në shërbime jetike të kësaj natyre, duke vepruar në kundërshtim me parimet themelore që rregullojnë ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve publike. Këto parime, të cilat kanë karakter detyrues për çdo organ publik, përfaqësojnë standarde bazë të shtetit të së drejtës dhe shtetit social, janë të sanksionuara qartë në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Ky kod u imponon të gjitha organeve të administratës publike, përfshirë organet e vetëqeverisjes vendore, detyrimin që ofrimi i shërbimeve të garantohet mbi bazën e ligjshmërisë, mosdiskriminimit, barazisë përpara ligjit, proporcionalitetit dhe objektivitetit. Respektimi i këtyre parimeve nënkupton se asnjë qytetari nuk mund t’i mohohet qasja në shërbime për shkak të rrethanave të tij të veçanta apo të gjendjes socio-ekonomike, por përkundrazi, është detyrim i pushtetit vendor të sigurojë trajtim të barabartë, gjithëpërfshirës dhe në respekt të dinjitetit njerëzor.

¹⁴ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social” , i ndryshuar; Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”

¹⁵ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Kreu III, neni 8, 9; Kreu VII, nenet 21,21,23,24; Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, neni 18, neni 69, pika 2.

Mosrespektimi i këtij detyrimi nga ana e Bashkisë Himarë përbën shkelje të dispozitave ligjore, dhe cënim të drejtpërdrejtë të të drejtave dhe interesave legjitime të qytetarëve të grupeve vulnerabël, duke u mohuar atyre aksesin në një nga të drejtat sociale themelore: të drejtën për strehim dhe mbështetje sociale. Kjo situatë, përveçse ngre shqetësime të natyrës juridike, evidenton edhe domosdoshmërinë për ndërhyrje urgjente të organeve përgjegjëse, në mënyrë që të garantohet respektimi i parimit të shtetit social dhe detyrimi kushtetues i institucioneve për mbrojtjen e shtresave në nevojë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur dhe po ndjek në vazhdimësi këtë problematikë, e cila ngërthen në vetvete një sërë të drejtash themelore dhe që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës e rrjedhimisht të drejtën themelore të njeriut, të njohur si “e drejta për jetën”, e garantuar në nenin 21, të Kushtetutës.

Përkushtimi i organeve të qeverisjes vendore për të adresuar konkretisht nevojat emergjente të banorëve, reflektohet mbi të gjitha duke siguruar zbatimin e detyrimeve ligjore për hartimin e planeve dhe programeve vendore dhe përmbushjen në tërësi dhe në një kohë sa më të shpjegueshme të tyre. Kjo siguron që angazhimi për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, të mos jetë vetëm një koncept, por të kthehet në ndryshim konkret dhe të qëndrueshëm në realitetin lokal. Veçanërisht në zona të caktuara, ku për shkak të mungesës së zhvillimit, qytetarët përballen me vështirësi strukturore, puna e institucioneve shtetërore duhet të jetë më intensive, e qëndrueshme dhe e vazhdueshme, me qëllim garantimin e trajtimit të barabartë dhe adresimin e problematikave me të cilat ndeshen ata në përditshmërinë e tyre. Duke qenë se këto sfida kanë natyrë strukturore dhe sistematike, përpjekjet për adresimin dhe zgjidhjen e tyre duhet të jenë të koordinuara dhe ndër-institucionale, në mënyrë që të sigurohet një mbrojtje efektive dhe e qëndrueshme për të gjithë qytetarët, sidomos për shtresat më vulnerabël të shoqërisë.

Nga ana tjetër, mirëqeverisja, e cila afirmohet në mënyrë të veçantë nga Karta e të Drejtave Themelore e BE, duhet të konsiderohet si një koncept prioritar në veprimtarinë e përditshme të organeve publike. Rritja e standardit të shërbimeve publike të ofruara nga organet e administratës në çdo nivel është në qendër të politikave dhe angazhimeve të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Europian dhe përafrimit të legjislacionit tonë me Acquis Communautaire.

Në përfundim, Avokati i Popullit në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të

drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se: "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive";

REKOMANDON:

- 1. Ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Himarë, për hartimin e programeve të strehimit për shtresat në nevojë në përputhje me legjislacionin në fuqi;*

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje **brenda 30 ditëve nga data e dërgimit.**

Për, sa më sipër, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe na informoni për qëndrimin tuaj ndaj tij, në një afat të arsyeshëm dhe ligjor.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

K O M I S I O N E R

VILMA SHURDHA

DV